



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më _____.____.2025

V E N D I M

Nr. 12, datë 27.08.2025

PËR

MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT: “PROJEKT-RREGULLORE “PËR PROCEDURËN DHE MËNYRËN E LLOGARITJES SË NIVELIT TË PAGESAVE VJETORE QË KRYHEN NË AKEP PËR MBIKËQYRJEN E TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE SHËRBIMEVE POSTARE”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Kledja Çikopano, në mbledhjen e datës 27.08.2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin për këshillim publik të dokumentit Projekt-Rregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP, për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit 17, pika 1, gërma “a” e nenit 19, nenet 20 dhe 36, të ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Nenet 27 dhe 31 të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti për këshillim publik: *"Projekt-Rregullore "Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare"*,
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;

V Ë R E N:

1. Ligji nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i cili ka hyrë në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton burimet e financimit, parimet dhe llojet e pagesave që kryhen në AKEP.
2. Projektregullorja është hartuar duke mbajtur parasysh përcaktimet e neneve 17, 19, 20 dhe 36 dhe të ligjit nr. 54/2024, si dhe nenet 27 dhe 31 të ligjit nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë".
3. Në nenin 20 të ligjit nr. 54/2024 dhe nenin 27 të ligjit nr. 46/2015, përcaktohet pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar, modalitetet e llogaritjes së kësaj pagese, si dhe afatet e pagesës të saj nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit postar.
4. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 dhe Rregulloren "Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik", miratuar me VKD nr. 21, datë 07.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14 dhe pikën 1 të nenit 15, të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit *"Projekt-Rregullore "Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare"*, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Procedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 më poshtë.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik *“Projekt-Rregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”*, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Lorenc Bako	Armer Juka